



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

Nr. 15428 Prot. (S.K.)

Kopje Nr. _____
Tiranë, më 05/05/2025

Lënda : Dërgohet vendimi i prokurorit për “Mosfillimin e procedimit penal”.

Drejtuar : Z. Flamur Noka
Partia Demokratike e Shqipërisë
Bul. “Zhan D’ Ark”, Nr. 11

TIRANË

Bashkëlidhur kësaj shkrese, po ju dërgojmë vendimin e prokurorit për mosfillimin e procedimit penal, në lidhje me kallëzimin penal Nr.145 të vitit 2025.

DREJTUESI I PROKURORISË

ALTIN DUMANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR
TIRANË

V E N D I M

PËR MOSFILLIMIN E PROCEDIMIT PENAL

Në Tiranë, më 05 Maj 2025

Unë **Sotir KLLAPI**, Prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë, pasi studiova aktet e kallëzimit penal Nr.145 datë 05 Maj 2025,

KONSTATOVA :

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Deputeti Flamur Noka ndaj shtetases Zegjine Çausi, ka regjistruar materialin kallëzues Nr.145 datë 05 Maj 2025 për veprat penale të *"Shpërdorimit të detyrës", "Korrupsionit aktiv në zgjedhje" "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore"*, dhe *"Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"*, parashikuar nga nenet 248, 328, 328/a, dhe 329 të Kodit Penal.

Nga sa rezulton nga materiali hetimor

Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, mbi bazën e kallëzimit të Partisë Demokratike të Shqipërisë, përfaqësuar nga Deputeti Flamur Noka ndaj shtetases Zegjine Çausi, ka regjistruar materialin kallëzues Nr.145 datë 05 Maj 2025 për veprat penale të *"Shpërdorimit të detyrës", "Korrupsionit aktiv në zgjedhje" "Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore"*, dhe *"Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"*, parashikuar nga nenet 248, 328, 328/a, dhe 329 të Kodit Penal.

Nga përmbajtja e kallëzimit, rezulton se të kallëzuarit janë kallëzuar në lidhje me disa pamje filmike të transmetuara në emisionin "Piranjat", sipas kallëzuesit të transmetuar në datën 14 Maj 2023.

Nga sa rezulton nga përmbajtja e kallëzimit, personi i kallëzuar ka pozicione zyrtare në Republikën e Shqipërisë, sipas kallëzuesit Inspektore në Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë e Roskovecit, çka tregon se ajo nuk është pjesë e subjekteve të posaçme të parashikuara nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Për këtë arsye, organi procedues do të shprehet vetëm veprën penale që ka në kompetencë lëndore atë të *"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"* parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, ndërkohë për veprat e tjera penale të cilat kanë nevojë për verifikime të metejshme, të dërgojë aktet e kallëzimit penal në prokurorinë kompetente që është Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Në kuadër të veprimeve verifikuese, është bërë transkriptimi i pamjeve filmike të emisionit "Piranjat" të cilat janë bashkëlidhur nga kallëzuesi në një CD.

Nga kqyrja e pamjeve filmike, organi procedues konstaton se në dallim nga sa pretendon kallëzuesi, nuk ekzistojnë elementët e figurës së veprës penale të *"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"* prashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Në dallim nga sa pretendon kallëzuesi në kallëzim, në materialin filmik bashkëlidhur, pavarësisht se nuk është pjesë e verifikimit të faktit penal që lidhet me veprën penale të *Korrupsionit aktiv në zgjedhje* prashikuar nga neni 328 i Kodit Penal, nuk dëgjohet as fraza e cituar prej kallëzuesit *"Vetëm me atë (Partinë Socialiste) fiton, nuk fiton me ata të tjerët (partitë e tjera në garë)"*.

Në një sekuencë të videos, duket që është biseda telefonike e regjistruar midis dy shtetasve, një mashkull dhe një femër, që sipas redaksisë së emisionit është shtetasi Gazmend Borgji dhe shtetasja Zegjine Çaushi. Në bisedën që është transkriptuar dhe nga emisioni dhe nga oficeri i policisë gjyqësore, rezulton që bashkëbiseduesja një moment shprehet *"...degjoje atë, paguan pesë milionë lekë minimalisht gjobën, dhe vetë bën një dy vjet burg, akoma nuk kupton ti tani, për zotin ti do vesh në burg ore...ndihmojë atë se nuk del keq, ndihmoje ore, po të zbatojë ligjin ajo...."*. Në vijim paraqitet një video në të cilën rezulton një interviste/pyetje të bëra nga një gazetarë shtetas Zegjine Çaushi duke zbritur në disa shkallë, por që nga transkriptimi i bisedës nuk paraqet interes për faktin objekt verifikimi.

Nga sa më sipër, organi procedues çmon se në rastin konkret nuk janë konsumuar elementët e figurës së veprës penale të *“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”* parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal.

Sipas kësaj dispozite, Neni 328 i Kodit Penal parashikon *“ofrimi ose dhënia e të hollave, të mirave materiale, premtimi për vend pune ose favorizime të tjera në cilëndo formë, për zgjedhësin ose persona të tjerë të lidhur me të, me qëllim marrjen e firmës për paraqitjen e një kandidati në zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votime, ose për tu angazhuar në veprimtari të paligjshme për mbështetjen e një kandidati ose partie politike, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një derinë pesë vjet”*.

Sikurse rezulton nga përmbajtja e dispozitës, kjo veprë penale, kryhet nëpërmjet ofrimit të një përfitimi, premtimit për një vend pune apo përfitimeve të çfarëdo lloji një qytetari konkret, me qëllim për të ndikuar në vullnetin e këtij të fundit për të votuar ose jo, apo për të votuar në një mënyrë të caktuar ose jo. Në analizë të provave të sipërcituara, në rastin konkret nuk rezulton ndonjë premtim të tillë, drejtuar një qytetari konkret, me qëllim për të ndikuar në vullnetin e këtij të fundit gjatë zgjedhjeve të vitit 2023.

Pakënaqësitë që mund të kenë qytetarët në lidhje me veprimtarinë e administratës, apo ndonjë nëpunësi të caktuar të administratës, nuk do të thotë se këta të fundit të gjitha veprimet qoftë edhe kur janë të kundërligjshme apo joetike, të kenë si synim të ndikojnë në vullnetin e qytetarëve për të zgjedhur.

Nga sa më sipër, fakti nuk përmban elementët e figurës së veprës penale të *“Korrupsionit aktiv në zgjedhje”* parashikuar nga neni 328 I Kodit Penal, fakti në këtë aspekt nuk ekziston e për rrjedhojë procedimi penal nuk mund të fillojë.

Në lidhje me veprat e tjera penale të pretenduara nga kallëzuesi *“Shpërdorimit të detyrës”*, *“Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore”*, dhe *“Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje”* parashikuar nga nenet 248, 328/a, dhe 329 të Kodit Penal, organi procedues çmon që të dërgojë për verifikimin e këtij fakti të pavarur nga faktet që merr në shqyrtim sipas kompetencës lëndore të tij, materialin kallëzues në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier.

Neni 290 i K.Pr. Penale parashikon: *“Procedimi penal nuk mund të fillojë kur... pika ç... fakti nuk parashikohet nga ligji si veprë penale ose kur del qartë se fakti nuk ekziston..”*

Nga sa më sipër, procedimi penal nuk mund të fillojë, pasi fakti i veprën penale të *"Korrupsionit aktiv në zgjedhje"* parashikuar nga neni 328 i Kodit Penal nuk ekziston.

Neni 291 i K.Penal, parashikon: *"Kur ekzistojnë rrethana që nuk lejojnë fillimin e procedimit, prokurori jep vendim të arsyetuar për mosfillimin e procedimit, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga regjistrimi i kallëzimit"*.

Për këto arsye, në mbështetje të neni 290/1 germa, "ç" dhe nenit 291 të K.Pr.Penale.

VENDOSA :

1. Mosfillimin e procedimit për kallëzimin penal Nr. 145 të vitit 2025.
2. Dërgimin e kopjes së të gjitha akteve të këtij materiali kallëzues, Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, me qëllim që të kryejë verifikimet e nevojshme apo kryerjen e veprimeve hetimore e procedurale në drejtim të ekzistencës së veprës penale të *"Shpërdorimit të detyrës"*, *"Përdorimit të funksionit publik për veprimtari politike ose zgjedhore"*, dhe *Kanosja apo dhunimi ndaj pjesëmarrësve në zgjedhje"* parashikuar nga nenet 248, 328/a, dhe 329 të Kodit Penal.
3. Vendimi t'u njoftohet të interesuarve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaqme të Shkallës së Parë Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga njoftimi i vendimit.

PROKURORI

SOTIR KILAPI 25

